

REPUBLICA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
 ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI

Nr/Br. 505/20
 Datë/Datum. 27/07/20
 PRISHTINË - PRIŠTINA

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nëniti 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Një ankesë kundër: Shërbimi Spitalor dhe Klinik Universitar i Kosovës

Për Aktivitetin e Prokurimit Nr. i AP: 00220-20-2103-1-1-1

Sa i përket tenderit për Furnizim me Barna nga Lista e re Esenciale në SHSKUK"

ANKESË

1. Identifikimi i ankuesit*

MATKOS PHARM SH.P.K.

(Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj)

rr.Shpëtim Rrobaj, Nr. 289, Prishtinë

(Adresa)

Prishtine

10000

(Vendi)

049-159-159

(Kodi postar)

(Numri Telefonit)

(Numri i Faks-it)

LIMAN

BUZOKU

(Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj)

Matkospharm@gmail.com

(Adresa elektronike)

27/07/2020

(Data e parashtrimit të ankesës)

SH. P. K.
 MatkosPharm
 PRISHTINE

(Nënshkrimi dhe vula)

*Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

(Emri i avokatit)

(Adresa e plotë)

(Numri i Telefonit)

(Numri i faks-it)

(Adresa elektronike)

(Data e parashtrimit të ankesës)

(Nënshkrimi dhe vula)

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

Shëno një përshkrim të shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar " Njoftimi për Kontratë" apo "Njoftimi për konkurs të projektimit" dhe, nëse aplikohet "Njoftimi për dhënie të Kontratës" "Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit", apo "Njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit", nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës:

Njoftimi për Kontratë me 19.05.2020
Proces verbali i hapjes së Tenderve
15.06.2020
Vendim i AK 23.07.2020
Kerkes për rishqyrtim 27.07.2020
Pezullim i aktivitetit të prokurimit LOT 14
Vendim i përgjigjes për rishqyrtim.PDF 27.07.2020

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, nëse aplikohet

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po ☐

Jo ☐

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, nëse aplikohet

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëturjeshe në aktivitetin e prokurimit ?

Po ☐

Jo ☐

6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkesë për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po ☒

Jo ☐

Nëse po, ofroni detaje mbi këtë fakt dhe bashkëngjit një kopje të vendimit të miratuar nga AK gjatë kontestit paraprak të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve në përputhje me nenin 108A të LPP-se.

7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs të Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënie të Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

Neni 59 i LPP-se

Neni 60 i LPP-se

*** Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthejë tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkojë një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kanë qenë të rrejshme ose mashtruese.*

8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

Në dokumenin e shpallur me datën 23.07.2020 me titull "Vendimi i AK" keni shpallur OE "LIRI MED" si fitues për LOT 14. Pas shikimit të dokumentacionit të OE të shpallur fitues, janë vërejtur disa gabime tek autorizimi nga prodhuesi, ku në autorizim nuk ceket tenderi perkatës por është një autorizim i përgjithshëm. Mirëpo, sipas dosjes së tenderit dhe njoftimi për kontratë, saktësisht tek pika 9.1 e dosjes së tenderit është kërkuar autorizim nga prodhuesi për këtë tender dhe jo autorizim i përgjithshëm siç e ka dorëzuar OE i rekomanduar për kontratë. Më poshtë është shkëputur pika 9.1 e dosjes së tenderit me qëllim të sqarimit të kësaj pike ankimore:

Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale	9.1 & 9.2	<div style="display: flex; justify-content: space-between;"> <div style="width: 48%;"> <p>Kapaciteti teknik dhe profesional</p> <p>Kërkesa 1. Autorizim nga prodhuesi për pjesëmarrje në këtë tender ose nga përfaqësuesi i autorizuar nga prodhuesi. Në rast të autorizimit nga përfaqësuesi-dileri, kërkohet edhe autorizimi i dilerit nga prodhuesi.</p> </div> <div style="width: 48%;"> <p>Dëshmita e kërkuar dokumentare:</p> <p>Evidenca 1. Autorizimi nga prodhuesi për pjesëmarrje në këtë tender ose nga përfaqësuesi i autorizuar nga prodhuesi (me të dhëna mbi prodhuesin adresë, nr. tel, email, web faqja etj, për mundësi të verifikimit). Në rast të autorizimit nga përfaqësuesi-dileri kërkohet edhe autorizimi i dilerit nga prodhuesi</p> </div> </div>
---	-----------	--

Andaj, duke pasur parasysh kërkesën e autoritetit kontraktues dhe autorizimin e përgjithshëm të OE të rekomanduar për kontratë, kërkojmë nga autoriteti kontraktues që të bëjë rivlerësimin e ofertave në pajtim me kërkesat e dosjes së tenderit sepse një vlerësim i tillë është në kundërshtim me nenin 59 të LPP-së pasi që ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve është në kundërshtim me vet dosjen e tenderit.

Sa i përket pretendimit të autoritetit kontraktues se tenderi i OE të rekomanduar për kontratë është me çmim më të lirë nuk qëndron për shkak se OE i rekomanduar për kontratë ka ofertuar me çmim prej 42,716.00€, kurse oferta jonë po ashtu është me çmim prej 42,716.00€. Mirëpo, duke pasur parasysh që OE i rekomanduar për kontratë nuk e posedon autorizimin e kërkuar sipas dosjes së tenderit, konsiderojmë se AK ka vepruar në kundërshtim me nenin 60 të LPP-së, pasi që neni 60 i LPP-së përcakton që autoriteti kontraktues do t'i jap kontratën publike operatorit ekonomik që ka dorëzuar tenderin e përgjegjshëm me çmimin më të ulët. Në rastin konkret, tenderi i OE të rekomanduar për kontratë nuk është tender i përgjegjshëm në mungesë të autorizimit të kërkuar sipas kërkesës së dosjes së tenderit.

9. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtresit të ankesës, në rast se përfshini pretendime për kompensim.

10. Lista e dokumenteve (dëshmime) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni Ankesës dokumentet e renditura më poshtë:

- a) *një kopje të publikimit të "Njoftimit për Kontratë" apo "Njoftimit për Konkurs të Projektimit.*
- b) *një kopje të publikimit për "Njoftimin e Dhënies së Kontratës" apo "Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimit për Anulim".*
- c) *një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës se tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.*
- d) *një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet,*
- e) *bashkëngjit një kopje të vendimit të miratuar nga AK gjatë kontekstit paraprak të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve në përputhje me nenin 108A të LPP-se,*
- f) *Dëshminë e pagesës së tarifës së ankimit në përputhje me nenin 118 të LPP-se, dhe*
- g) të gjitha korrespondencat e juaja me autoritetin kontraktues duke përfshirë e-mailat si dhe çdo informatë të shkruar që ka të bëjë me këtë aktivitet prokurimi, si dhe me secilin pretendim të paraqitur në ankesë.

h) Autorizimi i OP fitues për LOT 14

g+i) Autorizimi i MATKOSPHARM për LOT 14

****Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.*

